

Nr. 479. Prot.
Dt. 02.12.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 10931/2 Prot.

Tiranë, më 30/11 2016

URDHËR

Nr. 562 datë 30/11 /2016

PËR

AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, "MASTER I SHKENCAVE" NË "MENAXHIM BIZNESI", NË FAKULTETIN E EKONOMISË TË AKADEMISË PROFESIONALE TË BIZNESIT

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 138 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit nr. 424, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë, "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi", në Fakultetin e Ekonomisë të Akademisë Profesionale të Biznesit, që realizohet me 120 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite / 4 semestra, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë universitare "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi".
2. Akademia Profesionale e Biznesit të plotësojë rekomandimet e Vendimit Nr. 200, datë 17.10.2016, të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ngarkohet Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, të ndjekë plotësimin e rekomandimeve të dhëna në vendimin e Këshillit të Akreditimit.
4. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dhe Akademia Profesionale e Biznesit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

